



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:108966

Datë: 14.02.2024

Numri i dokumentit: 05329113

C.nr.698/2021

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, përmes gjyqtarës Florije Qerimi, me bashkëpunëtoren profesionale Shkurte Kadriu, në çështjen kontestimore të paditësit G D nga fshati P, K e Gj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Bardhosh Dalipi avokat nga Gjilani, kundër të paditurve B I dhe R I që të dy nga fshati P, Komuna e Gj, me objekt kontesti trazimi i posedimit, jashtë seancës gjyqësore, më datë 13.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET e tërhequr padia e paditësit G D nga fshati P, Komuna e Gj, e ushtruar kundër të paditurve B I dhe R I që të dy nga fshati P, Komuna e Gj, me objekt kontesti trazimi i posedimit.

A r s y e t i m

Paditësi G D nga fshati P, Komuna e Gj, përmes të autorizuarit të tij më datë 01.06.2021, ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurve B I dhe R I që të dy nga fshati P, Komuna e Gj, me objekt të kontesti trazim i posedimit.

I autorizuari i paditësit, përmes parashtresës së datës 09.02.2024, ka deklaruar se pas zgjerimit të padisë edhe ndaj të paditurit R I, të paditurit B I dhe R I kanë ndërmarrë veprime të caktuara në këtë drejtim duke e kthyer njësinë kadastrale P-707403054--0, në sipërfaqe prej 679 m2, vendi i quajtur "B", ZK Përlepnice, në gjendjen e mëparshme, andaj edhe e ka njoftuar gjykatën se e tërhjeq padinë e parashtruar në këtë gjykatë.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 261 paragrafi 3 të LPK-së, padinë e paditësit e konstatoi të tërhequr.

Nga të lartëcekruart e në pajtim me dispozitat e nenit 387.1 nën pika c) të ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.698/2021, me datë 13.02.2024

Gjyqtarja,
Florije Qerimi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.